

Në kuadër të projektit EntrAI CBHE Erasmus+, ne periudhen 9-11 /11 2021, përfaqësues nga Universiteti “Eqrem Cabej” morën pjesë në trajnimin 3-ditor në Kampin e Inovacionit të Universitetit të Turku-t, Finlandë, së bashku me universitete partnere shqiptare dhe ato partnere europiane.

Fokusi i këtij takimi, në kuadrin e WP2, ishte trajnimi i stafëve akademike të IAL-ve shqiptare si faze pararendëse e hartimit të moduleve të trajnimit për mësuesit e arsimit parauniversitar dhe studentëve, me qëllim zhvillimin dhe nxitjen e aftësive sipërmarrëse në edukim.

Gjithashtu, në takimin e Komitetit drejtues që pasoi trajnimin u diskutuan modalitetet mbi masat operacionale për zhvillimin e suksesshem të hapave të mëtejshëm që do të ndiqen në kuadër të këtij projekti.











